



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 33 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të marrin pjesë në mbledhjen e VIII-të të KPF-së e cila mbahet me datë: 09.08.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në ora 09:00.

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 09.07.2024,
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit 01Nr.06-18355/2024 për ri-alokim të mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzimet kapitale (ref.drejt fin)
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt korrik-gusht 2024,
5. Të ndryshme.

01Nr. 06-24008 2024
Klinë, më 31.07 2024



Kryesuesi
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Pozivajući se na član 52. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03/L-040, član 33 Statuta opštine Klina, članovi 15 i 16 i 17 Poslovnika o radu Skupštine i opštinskih odbora, predsednik komiteta za politiku i finansije opštine Klina, vrsi sledece:

OBAVESTENJE

Pozivaju se svi članovi Odbora za politiku i finansije da učestvuju na 7. sastanku KPF-a koji se održava: 09.08.2024. godine u sali Skupštine opštine Klina, sa početkom u 09:00 časova..

DNEVNI RED

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa sastanka održanog 09.07.2024.
3. Razmatranje predloga-odluke za izmenu-dopunu odluke 01 br.06-18355/2024 za preraspodelu budžetskih sredstava u okviru ekonomske kategorije kapitalni izdaci (odnosno fin),
4. Razmatranje podnesenih zahteva Odboru za politiku i finansije za mesec jul-avgusta 2024 godine,
5. Razno.

01Br. 06-24008 2024
Klina, 31.07 2024



Predsedavajuci
Fadil Gashi



01 Nr. 06-24059 /2024
Klinë, datë 31/07/2024

NGA:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit z.Enver Berisha
PËR:	Komitetin për Politik dhe Financa në Klinë
LËNDA:	Kërkesë, për plotësim ndryshimin e vendimit 01-nr.06-18355-2024 te dt.05.06.2024 .

- Kërkojmë nga Komitetin për Politik dhe Financa në Klinë që të futet si pikë e rendit të ditës plotësim ndryshimin i vendimit 01-nr.06-18355-2024 te dt.05.06.2024 .

Arsyetim: Vendimit 01-nr.06-18355-2024 te dt.05.06.2024 i cili ka marrë

Vlerësimi e ligjshmerise nga MAPL, ka pësuar ndryshime nga veprimi i përmbaruesit, i cili veprim ka ndikuar në ndryshimin e kërkesave për rialokim të mjeteve sipas vendimit të sipërshtuar, andaj kërkojme nga KPF. Që të bëhet plotësim ndryshim i i vendimit të lartëcekur.

Matërialin e detajuar do të ja bashkojme kësaj shkresë.

Me respekt.



Për/To/Za :	Asamblenë komunale – z. Fadil Gashi
Përmes/Through/Preko :	Z. Zenun Elezaj – kryetar i KK- Klinë
Nga/From/Od :	Drejtoria për Buxhet e Financa - z.Enver Berisha
Tema/Subjekt/Subjekat:	Kërkesë për plotësim ndryshimin e vendimit 01/Nr.06-18355/2024, dt.05.06.2024, për rialokim të mjeteve brenda OB
Data :	31.07.2024

Kërkojmë të bëhet :

Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 10

Brenda kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale, fondi 10, në kuadër të programit **Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660)**, nen-programi **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395)**, kodi funksional (0620)

- Nga projekti “Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore Siqevë-Ujmire-Shtarice” (kodi 54294), shuma **5,996.00 €**;
- Nga projekti “Ndertimi i shtratit te lumit Drini i Bardhe ne Kline,Volljak” (kodi 54334), shuma **24,000.00 €**.
- Nga projekti “Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore Videje-Polce-Paskalice-Jagode-Krusheve e Madhe” (kodi 54285), shuma **9,400.00 €**.
- Në projektin “Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore Krusheve e Vogel(trotuari Kline-Zllakuqan), kodi 54341, shuma **9,073.50 €**.
- Në projektin “Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore ne Gremnik”, (kodi 54292), shuma **24,000.00 €**
- Në projektin “Ndertimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastruktures nentokesore ne Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma **15,396.00 €**
- **Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 21**
- Nga projekti “Ndertimi i rrjetit te ujesjellesit ne LAgjen Arberia,Tigvesh,te Sheshi Nena Tereze, Dollc-Dresnik,Grabanice,Gremnik, Drenoc” (kodi 54332), shuma **4,497.00 €**
- Në projektin “Ndertimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastruktures nentokesore ne Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma **4,497.00 €**.

Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 22

- Nga projekti “Asfaltimi i rrugës Afrim Haliti në Jashanicë” (kodi 52442), shuma **2,849.51 €**
- Nga projekti “Ndertimi i parkut industrial për Klinë” (kodi 52447), shuma **9,000.00 €**
- Nga projekti “Ndertimi me gure i sheshit "Muje Krasniqi" ne Kline “ (kodi 54004), shuma **1,250.80 €**
- Në projektin “Ndertimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastruktures nentokesore ne Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma **28,376.81 €**.
- **ARSYETIM: Rialokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.**



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr _____/24

Klinë, dt: _____/24

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e shtatë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 09.07.2024, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, drejtorin e Financave, z. Enver Berisha, drejtorin e Administratës, z. Binak Syla, OSBE-në, policinë e Kosovës dhe gjithë të pranishmit.

Gjithashtu, theksoi se përveç pikave të cilat janë për shqyrtim në rend të ditës, të futet si pikë edhe kërkesa nga Drejtoria e Kadastrës, Pronësisë dhe Gjeodezisë për propozim-vendimin e ekzekutivit për këmbimin e pronave me qëllim realizimin e projekteve infrastrukturore.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar më datë 07.06.2024,
3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-qershor 2024 (ref.drejt.fin),
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Klinës për vitin 2023 (ref. ekz.),
5. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit(ref. ekz),
6. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi me qytetarë i mbajtur nga kryetari i komunës më datë 25.06.2024,
7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt qershor-korrik 2024,
8. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Prezent jemi të gjithë dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen. A ka dikush për rend të ditës?

Me 7 vota PËR u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsytimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Unë edhe njëherë po e konfirmoj se të gjithë jemi prezentë.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar më datë 07.06.2024.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush? Kush është për?

Me 7 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-qershor 2024 (ref.drejt.fin.).

Fadil Gashi, kryesues: Ju e dini tash, se për çdo tremujor ne na vjen raporti nga Drejtoria dhe i falënderojmë për saktësinë e afateve që e bëjnë edhe ju kisha lutur drejtorit që të na bëj një prezantim dhe pastaj kishim hapur debat. Urdhëro, drejtor!

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për ju përfaqësues të KPF-së, OSBE-në, kolegë të mi! Tashmë veç është një rregull i raportimeve të shpenzimeve të buxhetit para komitetit dhe para asamblesë dhe kjo duke u bazuar në Ligjin për Buxhet dhe Ligjin për Financa Publike. E vërteta është se ky raport financiar i këtij gjashtëmujori është shumë më specifik se gati secili raport që ka pasur komuna ndonjëherë në historinë e funksionimit që nga 2008-ta e deri tash, për faktin se ato rekomandime edhe ne si drejtor që kemi dhënë në të kaluarën para jush kemi thënë se është mirë organizata buxhetore brenda komunës me pasur parasysh që shpenzimet t'i bëjmë edhe konform kohës, ashtu siç ishte dashur të jetë gjithëherë, për shkak se na ka ndodhur prej pandemie e këndeje, dmth faza e parë e buxhetit tremujori dhe gjashtëmujori kanë pasur ngecje për shkak të kohës dhe kufizimeve që kanë. Realisht në këtë vit ky shpenzim i këtij buxheti është ndër shifrat më të mira që ka pasur komuna ndonjëherë, dhe duke u bazuar edhe në kujdesin që secila drejtori veç e veç e ka pasur para vetës këtë formë të shpenzimeve të mjeteve, por, duke u bazuar që kemi marr rekomandime edhe nga asambleja vitin e kaluar që t'i kushtohet më shumë kujdes këtij shpenzimi, unë po jap disa shifra,

mandej mund të bëjmë edhe debat së bashku.

Po fillojmë me kategorinë e parë që është paga dhe mëditje, prej 7,936,000.00 shpenzimet janë bërë 4,182,000.00 që i bie 52.69% , dmth në paga dhe mëditje janë shpenzuar 52.69% të mjeteve; në mallra dhe shërbime, prej 1,742,000.00 janë shpenzuar 867,572.00 apo 49.78%; në shërbime komunale prej 250,000.00 janë shpenzuar 151,408.00 apo 60.56%; subvencione dhe transfere, dmth planifikimi ka qenë 658,000.00 nga sa janë shpenzuar 266,424.00 euro apo 40.49% ; në kapitale në këtë rast i kemi prej 4,649,000.00 janë shpenzuar 1,975,000.00 apo 42.40% .

Krahasuar me vitin e kaluar është ndryshim esencial i shpenzimit të vjetër dhe ky raport në total të shpenzimeve të deritashme kap shifrën prej 48.85% . Ju nuk e di a keni marr materialin me kohë, i keni edhe shpenzimet ku janë bërë nëpër projekte të caktuara dhe besoj nuk kisha pasur nevojë me i lexuar tash për shkak se i keni, po nëse diku ka nevojë për ndonjë sqarim, ne jemi këtu, faleminderit !

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor! Po hap debat për këtë raport që u prezantua, kush e do fjalën?

Tunë Deda: Po, kryesues, faleminderit, drejtor për prezantimin edhe më vjen shumë mirë që janë kryer punët me kohë dhe janë kryer punë cilësore, vetëm desha të ju falënderoj shumë!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, a ka dikush tjetër ?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-qershor 2024, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 6 vota PËR, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Klinës për vitin 2023 (ref.ekz.).

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Po, kryesues, faleminderit! Realisht, ky raport i auditorit është kompetencë e kryetarit të komunës, po në pika të shkurtra po e bëj një prezantim para jush, por në seancë besoj kryetari më shumë merret me këtë punë. E vërteta është që, pas një inspektimi të gjatë nga auditorët rreth pesë javë u janë marr mostrat e qindra lëndëve në komunën tonë, duke i përfshirë gjitha drejtoritë një për një, dmth nga 10 drejtori kanë marr materiale e më së shumti dihet që janë marr materiale në Drejtorinë e Urbanizmit, tani pason Drejtoria e Financave, e Bujqësisë, e Kulturës, e kështu me radhë, por nga krejt këto mostra që auditorët i kanë vlerësuar, ka dal që një asnjë rast nuk ka asnjë keqpërdorim dhe raporti është pozitiv për komunën.

Raporti është një prej raporteve më të mira që i ka një komunë dhe ato gjetje që janë krejtësisht minimale dhe teknike, ato janë të përshkruara edhe në raport dhe në planin e veprimit, që më vonë ta kemi edhe në rend të ditës për ato gjetje që ata i kanë bërë. Gjetjet janë kryesisht thash të natyrave teknike, duke përfshirë dmth në vonesë, në pagesë, në kontratë, e kjo ndodh kryesisht në fund të vitit kalendarik për shkak se faturat vijnë në muajin dhjetor e deri në muajin shkurt nuk ka buxhet, e afati kohor i një pagesës është 1 muaj, dmth këtu kanë ndodhur dy-tri fatura që realisht s'kanë mundur me zënë kohën e pagesës. Fatura ka ardhur para zotimit të mjeteve, dmth

fillimisht duhet zotimi i mjeteve, mandej duhet fatura, por janë disa organizata buxhetore që realisht nuk po mundemi m’i gjet këtu bashkë me këto, qysh është Posta, KEDS-i, disa kompani që realisht e sjellin faturën pa u konsultuar me neve dhe pa e kryer zotimin e mjeteve me ne dhe dmth edhe kjo është një gjetje e lehtë.

Mandej ka një gjetje të lehtë tek Drejtoria e Bujqësisë, që të saktësohen kriteret për ndarjen e këtyre subvencioneve, që ato kriteret të jenë të procesuara dhe të inspektohen deri në fund. Ka gjetje te pjesa e tatimit në pronë, që qysh kur janë regjistruar fillimisht shtëpitë e taksapaguesve nuk është marr numri personal. Në vitin e kaluar e kemi bërë një përpjekje jashtëzakonisht të madhe me i siguruar këta numra dhe kemi mbërritur me i siguruar një numër bukur të konsiderueshëm, por kanë mbetur ende disa pa u plotësuar, dmth edhe ky është një sugjerim i auditorëve gjeneralë që me pasur parasysh që gjatë daljes në terren me i siguruar edhe numrat personal të atyre familjeve që janë taksapagues dhe u mungon ky numër personal. Dmth kryesisht janë gjetje krejtësisht minimale, por ne besoj i kemi dhënë vlerësimet tona, i kemi dhënë afatin tonë në plan të veprimit dhe unë besoj që këto me kohën do të tejkalohen edhe është një keqklasifikim që është gjetur për të cilin dmth ne jemi dakorduar në atë formë me u kryer, po kemi menduar që kemi të drejtë, por, nuk kemi pasur; është fjala për mjetet që ja kemi dhënë policisë, droni me disa pajisje të veta është paguar prej kapitaleve, është dashur të paguhet prej mallrave dhe shërbimeve, dmth i vetmi keqklasifikim ka qenë ky, dmth që është dashur me u paguar prej një kategorie tjetër, por, që nuk ka keqpërdorim. Pra, këto janë gjetjet e auditorit, por edhe njëherë po ju them edhe përkundër një vendimi të jashtëzakonshëm që e kanë bërë ata për pesë javë, komuna e Klinës ka dal me raport jashtëzakonisht të mirë, faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor! A ka dikush?

Tunë Deda: Unë desha ta falënderoj ekzekutivin shumë se kanë punuar shkëlqyeshëm.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2023, me 6 vota PËR, pa ndonjë vërejtje, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 5 . Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit (ref.ekz).

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së, me 6 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 6. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi me qytetarë i mbajtur nga kryetari i komunës më datë 25.06.2024.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të procesverbalit nga takimi me qytetarë

i mbajtur nga kryetari i komunës, me 6 vota PËR, pa debat, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt qershor-korrik 2024.

Kërkesa 1.

Kërkesë e parashtruar nga përfaqësuesi i bashkësisë lokale në Grabanicë, z. Sejdi Baleci dhe drejtori i SHFMU “Azem Bejta” në Grabanicë, z. Fadil Berisha, me anë të së cilës kërkojnë dhënien e pëlqimit për vendosjen e bustit të heroit kombëtar “Azem Bejta” në oborrin e shkollës në Grabanicë e cila e mban të njëjtin emër.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar për vendosjen e bustit të heroit kombëtar “Azem Bejta” në oborrin e SHFMU në Grabanicë e cila mban po këtë emër, KPF bazuar në faktin se SHFMU në Grabanicë mban emrin “Azem Bejta” me 6 vota PËR, rekomandoi që të bëhet vendosja e bustit, pasi nuk paraqet pengesa vendosja e tij.

Pika 8. Shqyrtimi i propozim vendimit për këmbimin e pronave.

Kryesuesi i komitetit, z. Gashi, theksoi se për realizimin e disa projekteve infrastrukture, ekzekutivi i Komunës së Klinës ka filluar procedurat për këmbimin e pronave si në vijim:

1. Pjesa e parcelës kadastrale, **nr.441-2** ZK Klinë, me sipërfaqe prej **4 m²** (katër metra katror), vendi i quajtur “Fshati”, e regjistruar në emër të pronarit privat, Arben Coli, për realizimin e qëllimit të ligjshëm publik, realizimi i projektit “**zgjerimi i trotuarit në sheshin “ Mujë Krasniqi”**”, do të këmbetet me pjesën e parcelës nr.443-4 ZK Klinë, me sipërfaqe prej **4 m²** (katër metra katror), në emër të **Komuna Klinë**.
2. Pjesa e parcelës kadastrale, **nr.235-12** ZK Klinë, me sipërfaqe prej **101 m²** (një ari e një metër katror), vendi i quajtur “Thanishtë”, e regjistruar në emër të pronarit privat, Gjon Berisha, për realizimin e qëllimit të ligjshëm publik realizimi i projektit “**asfaltimi i rrugës me interes publik**”, do të këmbetet me pjesën e parcelës nr.235-4 ZK Klinë me sipërfaqe prej **101 m²** (një ari e një metër katror) në emër të **Komuna Klinë**.
3. Pjesa e parcelës kadastrale, **nr.2246-0** ZK Dresnik, me sipërfaqe **219 m²** (dyqind e nëntëmbëdhjetë metra katror), vendi i quajtur “Përlinë”, e regjistruar në emër të pronarëve privat, Bujar dhe Zoje Dakaj, bashkëpronarë 1/2, për realizimin e qëllimit të ligjshëm publik, realizimi i projektit “**rreth rrotullimi në pjesën e parcelës së lartshënuar**”, do të këmbetet me pjesën e parcelës nr.1949-0 ZK Dresnik, me sipërfaqe **219 m²** (dyqind e nëntëmbëdhjetë metra katror), në emër **Pronë Shoqërore Rrugët**.

4. Pjesa e parcelës kadastrale, **nr.541-1** ZK Klinë, me sipërfaqe prej **55 m²** vendi i quajtur “Fshati”, i regjistruar në emër të pronarit privat, Radisav Mikiq, të cilën e përfaqëson “ERA INVEST” me pronar, Sokol Elezaj, sipas autorizimit për realizimin e qëllimit të ligjshëm publik, zgjerimi **i rrugës me interes publik**, do të këmbëhet me pjesën e parcelës **nr.541-2** ZK Klinë, me sipërfaqe prej **55 m²** në emër të **Komuna Klinë**.
Po ashtu, kërkoi që e njëjta të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend ashtu siç është propozuar nga ekzekutivi.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të ekzekutivit për këmbimin e pronave me qëllim realizimin e projekteve infrastrukturore, me 6 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 9.Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush? Atëherë më lejoni ta mbyll këtë takim, faleminderit për pjesëmarrje!

**Procesmbajtësja,
Monika Palushi**

**KRYESUESI,
Fadil Gashi**

KUVENDIT KOMUNAL NË KLINË

ZYRËSË SË KRYETARIT TË KOMUNËS, z.Zenun Elezi

DREJTORISË SË BUJQËSISË NË KOMUNËN E KLINËS

NGA: Hagjija Mulaj, me nr. personal: [REDACTED], nga fsh. Jashanicë K. Klinë

Nr. lista org. Whi.	1
Organi. Jod.	1:st
LËNDA: K Ë R K E S Ë	
-Për Kompensim të dëmëve, të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore (Dëmi i shkaktuar nga Insektet)	

Parashtruesi thekson se: jeton ne kushte tejet të veshtira ekonomiko-sociale dhe nuk ka asnje burim te të ardhurave nga të cilat do mund të sigurohej mireqenja për jetën e tij dhe të familjes.

Andaj së fundi nga fatkeqësit natyrore më është bërë dëmë i lartë nga Insektet, të cilat kanë pushtuar e gjithë fshatin Jashanicë, Insektet më kanë dëmtuar Pemët, Perimet, gjelbrimin në oborr, si dhe Fasaden e Shtëpisë, e gjithë ky dëmë i shkaktuar nga Insektet, të cilat ditë më pare kanë pushtuar fshatin Jashanicë, tani për rigjenerimi të gjithë atij **dëmi të shkaktuar parshtruesit të kërkesës po i kushton një shumë e lartë financiare.**

Andaj, edhe është hera e pare që po kërkoi me shkrim nga Komuna e Klinës që të më mbështetni apo përkrahni në Kompensim të dëmeve të shkaktuara, që të bëjë Renovimin e Fasadës së shtëpisë, si dhe të i mjelli sërish Pemët dhe Perimet e dëmtuara nga inseketet, andaj ju **PROPOZOHET** që të merrni në shqyrtim urgjent kërkesën e time, për kompensim të dëmëve të shkaktuara nga **INSEKTET-fatkeqësi natyrore.**

Duke u bazuar në të thënat e lartëcekuar dhe bazuar në gjendjen e rëndë ekonomike apo pamundësin për të rregulluar apo renovuar Fasaden e Shtëpisë, si dhe për ti Rigjeneruar Pemët, Perimet dhe Gjelbërimin e dëmtuar, parashtruesi i kërkesës **KËRKON** nga organet administrative të lartcekura, që të ja ofroni një mbështetje momentale-financiare apo Kompensim të dëmëve të shkaktuara nga Insektet-Fatkeqësi natyrore .

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, shpresoj të më aprovohet kërkesa ime !

Klinë, dt.05.07.2024

Parashtruesi i kërkesës:

Hagjija Mulaj

Hagjija Mulaj-[REDACTED]

PËR: Kryetarin të Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj,

KOPJE: Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Klinës, z. Fadil Gashi.

24.07.2024

LËNDA: Kërkesë për implementimin e ndërtimit të dy ashensorëve në hyrjen A dhe B, në objektin afarist banesor "Raffi", në rrugën "Abedin Rexha", përballë postës në Klinë, -

01-360-23215/24

Kërkojmë nga Komuna e Klinës, nga kryetari i Komunës së Klinës, Z. Zenun Elezaj, si dhe kompetentet e tjerë për çështje ndërtimore që të na ndihmoj financiarisht në realizimin e ndërtimit të dy ashensor të jashtëm në Objektin afaristo - banesor "Raffi" P+6 në Klinë, për arsye se objekti në fjalë është një ndër objektet e para të ndërtuara pas luftës në Komunën e Klinës dhe nuk posedon ashensor. Objekti është gjashtë katësh dhe për banorët vazhdimisht krijohen probleme për lëvizjen e tyre dhe bartjen e gjërave për jetesë dhe të paisjeve të ndryshme të nevojshme për banorët e këtij objekti. Përndryshe në objektin e tillë edhe komuna e ka pjesën e vet të pronësisë afariste dhe banesore dhe ka pra interesin e rregullimit të ashensorve përkatës.

Sqarojmë më tej se edhe Kuvendi i Komunës kohë më parë kishte miratuar një kërkesë tonën dhe projektin e tillë e kishte futur në listën prioritare të projekteve që do realizoheshin në vitin 2024.

Kërkojmë nga komuna që të na ndihmoj financiarisht dhe në aspektin urbanistik ngase nevojitet një renovim në katin e parë ku fillon ashensori, duke u nisur edhe nga fakti se objektet mbi 4 kate edheashtu ligjërisht do duhej të kenë ashensorët adekuat. Po sqarojmë edhe atë se të gjithë banorët në pamundësi që komuna ta mbulojë të gjithë pjesën financiare do të jemi të gatshëm të participojmë me vlerat adekuate sipas mundësive tona buxhetore.

Mbesim me shpresën që kërkesa jonë do të realizohet në tërësi!

Nënshkrimet e banorëve të objektit:

Nr. rendor:	Emri dhe mbiemri:	Nr. personal i letërnjoftimit:	Nënshkrimi:
1.	Rexhep Veseli	[Redacted]	[Signature]
2.	ALI SHALA	[Redacted]	[Signature]
3.	Elmi Dushi	[Redacted]	[Signature]
4.	Ureshmir Veseli	[Redacted]	[Signature]
5.	Haxhi Meta	[Redacted]	[Signature]
6.	Ismet Hoti	[Redacted]	[Signature]
7.	Isak Thaqi	[Redacted]	[Signature]
8.	ARBEN LIMANI	[Redacted]	[Signature]
9.	Hagji Dragidella	[Redacted]	[Signature]
10.	Emine Paga	[Redacted]	[Signature]
11.	Lumir Ramu	[Redacted]	[Signature]
12.	SELVIE GASHI	[Redacted]	[Signature]
13.	Alfred Vener	[Redacted]	[Signature]
14.	ISMET RASHIT HYSENI	[Redacted]	[Signature]
15.	Fejmi Dragidella	[Redacted]	[Signature]
16.			
17.			
18.			



Kuvendi i Komunës Klinë

01 Nr prot. 06-18355/2024

Datë: 05.06/2024

Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së datës: 20.05.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e V-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur me datën: 30.05.2024 mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për ri-alokim të mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi -300), fondi burimor 10, Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 21, Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 22.
2. **Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) fondi burimor 10.**
 - 2.1 Brenda kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale, fondi 10, në kuadër të programit **Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660)**, nen-programi **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395)**, kodi funksional **(0620)**
 - 2.2 Nga projekti “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë-Ujmirë-Shtaricë” (kodi 54294), shuma **5,996.00 €**;
 - 2.3 Nga projekti “Ndërtimi i shtratit te lumit Drini i Bardhe ne Klinë, Volljak” (kodi 54334), shuma **7,495.00 €**.
 - 2.4 Nga projekti “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Videjë-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe” (kodi 54285), shuma **9,400.00 €**
 - 2.5 Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore ne Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma **22,891.00 €**
Arsyetim: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.

3. Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 21

3.1 Nga projekti “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Lagjen Arberia, Tigvesh, të Sheshit Nena Tereze, Dollc-Dresnik, Grabanice, Gremnik, Drenoc” (kodi 54332), shuma 4,497.00 €

3.2 Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore në Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma 4,497.00 €, **Arsyetim: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.**

4. Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 22

4.1 Nga projekti “Ndërtimi i shtigjëve të ecjës dhe infrastruktura rrugore në Gryken e Jarinës - Pogradjë” (kodi 52443), shuma 15,276.50 €

4.2 Nga projekti “Asfaltimi i rrugës Afrim Haliti në Jashanicë” (kodi 52442), shuma 2,849.51 €

4.3 Nga projekti “Ndërtimi i parkut industrial për Klinë” (kodi 52447), shuma 30,000.00 €

4.4 Nga projekti “Ndërtimi me gure i sheshit "Muje Krasniqi" në Kline” (kodi 54004), shuma 1,250.80 €

4.5 Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore në Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma 49,376.81 €.

Arsyetim: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

6. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunës;**
- **Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi;**



**Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi**